

FJALA E DEPUTETIT ALBAN XHELILI

E ENJTE 15 NËNTOR 2021

E nderuar zonja Kryetare,

Të nderuar kolegë dhe kolege deputete,

Buxheti i vitit 2022 është buxheti më i madh dhe nuk do të lodhemi së përsërituri këtë, si nga ana sasiore (ndoshta shumica juaj këtu, djathtas, kur ne themi “më i madhi”, kupton vetëm shifra absolute), ashtu dhe nga ana cilësore. Kur them që është buxheti më i madh nga ana cilësore, nënkuptoj gjithë angazhimin tonë në fushatën elektorale për të pasqyruar në këtë buxhet hallet e qytetarëve. Këtu do t’ju kërkoja të mos e keqinformoni opinionin publik në lidhje me ndryshimet që kanë ndodhur në paketën fiskale. Këtë do t’ju kërkoj si një ndihmë që duhet t’ua jepni të gjithë qytetarëve dhe, në radhë të parë, vetes suaj, që të mos kthehemi në keqinformime të ndodhura në të kaluarën, siç mund të ketë ndodhur, për shembull, me ligjin për fiskalizimin, të cilin e interpretuat si një dënim me vdekje për bizneset shqiptare, në një kohë kur nuk është gjë tjetër veçse një ndihmë shumë e madhe për të gjitha bizneset dhe, kur them biznese, e kam fjalën për bizneset e rregullta dhe të formalizuara. Buxheti i vitit 2022 natyrisht që është buxheti më i madh dhe më i mirë, sepse synon një ulje të pandalshme e të qëndrueshme të borxhit publik dhe deficitit. Vlerësimet më të fundit të bëra nga FMN-ja, Banka Botërore apo BERZH-i japin një trend për vitin 2021 në 7,6% rritje, me një ecuri të qëndrueshme për vitet e ardhshme, 4,1% deri në vitin 2024. Edhe këtu kam një rekomandim. Jemi marrë vesh shumë mirë me kolegët e opozitës në komision, këtë nuk e them fare me ironi, por kam ndier një kënaqësi për kolegët që kam përballë, dhe do të kërkoja që, ata që janë praktikë me shifrat, të flasin me shifra.

Ka plotë këtu, nga ne dhe nga ju, që mund të flasin në formë politike. Le t’i lëmë pak shifrat, sepse duke thënë shifra, siç ndodhi këtu më parë, bëjmë dhe gabime të rënda. Natyrisht, ky është buxheti më i mirë, sepse bën një indeksim pensionesh, dhe këtu themi që jemi socialistë, sepse nuk besoj se pensionistët janë shtresë luks, por janë shtresë në nevojë, dhe për këtë arsye kemi menduar të bëjmë një indeksim me 2,6 miliardë lekë dhe buxheti e parashikon këtë. Patjetër që ky është buxheti më i mirë, sepse është hera e parë që për pensionistët parashikon bonusin e fundvitit, që gjithmonë ka qenë një element në të cilin shikohej trendi i vitit, pra, në qoftë se do të kishim një trend pozitiv, pensionistët do ta merrnin bonusin, në të kundërt, nuk do ta merrnin.

Gjithashtu, ky është buxheti më i mirë, sepse parashikon dhe një fond prej 1 miliard lekësh për turizmin, për të cilin ngarkohet Agjencia Kombëtare e Bregdetit, për pastrimin e plazheve, edhe pse dua të them që ka pasur një përmirësim shumë të madh në lidhje me pastërtinë në plazhe. Problemi i madh, me të cilin jemi hasur vjet, ka qenë ai i mbetjeve dhe ky buxhet (jo më kot thashë që është dhe buxheti më cilësor) edhe për mbetjet parashikon një fond prej 500 milionë lekësh rritje. Tani dua të kaloj pak dhe në trajtimin e paketës fiskale, që është pjesë e integruar e buxhetit të shtetit. Një nga parimet kryesore që është pasur në vëmendje kur është hartuar paketa fiskale ka qenë rishikimi i politikave fiskale, duke korrigjuar përjashtimet dhe tarifat e reduktuara. Qëllimi këtu nuk ka qenë favorizimi i dikujt dhe dënimi i dikujt tjetër, por ka qenë vetëm e vetëm të luftohet informaliteti dhe të kemi një përafrim me legjislacionin e Bashkimit Europian. Gjithashtu, një vëmendje e madhe i është kushtuar dhe përmirësimit dhe administrimit tatimor. Të gjithë jemi koshientë që ka pasur një rritje

shumë të ndjeshme në lidhje me grumbullimin e të ardhurave si rezultat i administrimit tatimor. Pra, qëllimi i paketës fiskale në tërësi ka në fokus krijimin e një sistemi tatimor neutral, që shmang deformimet, që është eficient dhe i thjeshtë për t'u zbatuar nga tatimpaguesit. Siç e thashë edhe më sipër, politika fiskale ka në fokus tri elemente kryesore: përafrimin drejt parimeve të taksimit të direktivave të Bashkimit Europian; shmangien e disa problematikave që kanë ndodhur dhe si rezultat i administrimit, si dhe zbatimin e rekomandimeve të FMN-së në lidhje me përjashtimet. Kur thashë pak më parë që kemi detyrimin ta informojmë drejt opinionin publik, mendja më shkoi (besoj se edhe shumicës) tek fermerët. I kam ndjekur me vëmendje të gjitha diskutimet politike që kanë ndodhur në lidhje me 6- përqindëshin, i cili besoj se fermerëve të shkretë u del në ëndërr. Keni harruar t'u thoni fermerëve që me atë 6-përqindëshin, siç ka qenë, kanë humbur. Pse kanë humbur? Sepse e kemi verifikuar dhe në komision me grupet e interesit që kemi thirrur, që fermerëve nuk u ka vajtur 6-përqindëshi, por ai ka qenë një normë abuzive fitimi në xhepat e atyre që lëshonin fatura për fermerët.

Kam bërë një deklaratë në komision, ku e kam diskutuar këtë, dhe u kam thënë grumbulluesve: "Tani nuk e keni më ju në dorë këtë pjesë; nuk e jepni dot më ju. 6-përqindëshi, që kishte një rezultat 750 milionë lekë, do të shndërrohet në 1,25 miliardë dhe do t'u shkojë fermerëve në formën e subvencionit". Pra, nëse fermerët dalin atje se do t'u ikë kjo pjesë e pagesës, të jenë të bindur se do të marrin më tepër seç merrnin nga grumbulluesit. Në qoftë se dalin atje për të mbrojtur interesat e një grumbulluesi, të mos bëhen mish për top. Gjithashtu, është përmendur që ne, si josocialistë, mbështesim oligarkët. Themi që nga 50 milionë ua kemi bërë 500 milionë dhe harrojmë se ai që bënte një investim 500 milionë për makineri përfitonte dhe nga skema e mëparshme, se fillonte vlerësimi që nga 50- milionëshi. Dua të prek dhe diçka tjetër në lidhje me tatimin mbi të ardhurat për pagën. U fol që pagat nga 50 deri në 100 mijë lekë taksohen më tepër. Bëjeni edhe një herë llogarinë dhe do ta shikoni që e keni gabim. Këto paga tatohen më pak. Faleminderit!